

Analiza e Qeverisjes së Hapur të Zyrës së
Kryeministrit në Kosovë (2023)

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË KOSOVË (2023)

RRETH PUBLIKIMIT

Ky dokument u zhvillua si pjesë e projektit ‘**Përmirësimi i Qeverisjes së Mirë 5.0&6.0**’, i mbështetur nga **National Endowment for Democracy (NED)**, dhe i implementuar nga **Open Data Kosovo (ODK)**.

AUTORËT

Dafina Olluri dhe Anita Selita

VERSIONET GJUHËSORE

SHQ, ANG, SER

Përfunduar në PRILL, 2025 © ODK

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të NED. Riprodhimi dhe përkthimi për qëllime jofitimprurëse janë të autorizuar, me kusht që të dihet burimi dhe publikuesi të njoftohet paraprakisht dhe të dërgohet një kopje.

ANALIZA E QEVERISJES SË HAPUR TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT NË KOSOVË (2023)

PËRMBAJTJA

Hyrje	1
Metodologjia e Hulumtimit	2
QASJA	3
NDËRGJEGJSIMI	5
INTEGRITETI	5
TRANSPARENCA	6
ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË AKTIVITETET E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	8
REKOMANDIMET	9

HYRJE

Zyra e Kryeministrit (ZKM), si institucioni kryesor ekzekutiv në Kosovë, luan një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore, koordinimin ndërinstitutional dhe mbikëqyrjen e reformave kryesore. Që nga viti 2022, ZKM ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të rritur transparencën institucionale, duke forcuar lidhjen mes qeverisjes dhe qytetarëve. Si qendra e vendimmarrjes qeveritare, transparenca dhe llogaridhënia mbeten shtylla themelore për ndërtimin e një qeverisjeje efektive dhe të besueshme.

Në përpjekje për të rritur transparencën dhe qasjen në informacion, ZKM ka ndërmarrë disa masa konkrete, si publikimi i vendimeve qeveritare, raporteve të punës dhe të dhënave mbi shpenzimet publike në platforma zyrtare. Po ashtu, digjitalizimi i shërbimeve publike dhe përdorimi i platformave online kanë lehtësuar komunikimin me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, duke e bërë informacionin më të hapur dhe të qasshëm. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, ZKM përballet ende me sfida të mëdha në këtë drejtim. Edhe pse ekziston një kornizë ligjore për transparencën dhe llogaridhënien, zbatimi i saj në praktikë mbetet i pjesshëm. Përmirësimi i qasjes në informacion kërkon jo vetëm vullnet politik, por edhe një shfrytëzim më të avancuar të teknologjisë për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e institucioneve.

Në kuadër të zhvillimit dhe integritetit evropian, ZKM po ndërmerr hapa të vazhdueshëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, duke e bërë qeverisjen më të hapur dhe më të besueshme. Përmes digjitalizimit të shërbimeve, publikimit të rregullt të vendimeve qeveritare dhe krijimit të platformave për konsultim publik, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile kanë më shumë mundësi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. Po ashtu, rregulloret e reja dhe përmirësimi i mekanizmave të mbikëqyrjes forcojnë përgjegjshmërinë institucionale, duke siguruar një administratë më efikase dhe të përkushtuar ndaj standardeve demokratike dhe evropiane.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Analiza e vitit 2023 bazohet në katër parime thelbësore që përcaktojnë hapjen institucionale të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) sipas Indeksit të Hapjes Rajonale. Ky indeks mat nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare në Ballkanin Perëndimor, duke u fokusuar tek qasja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në informacionin publik.

Vlerësimi i ZKM-së është realizuar mbi katër shtylla kryesore: transparencën, qasjen, integritetin dhe ndërgjegjësimin institucional. Transparenca lidhet me publikimin e informacionit mbi strukturën organizative, menaxhimin e buxhetit dhe proceset e prokurimit publik, duke siguruar që qytetarët të kenë akses të qartë dhe të lehtë në këto të dhëna. Qasja përfshin nivelin e informimit publik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve përmes konsultimeve publike, si dhe mekanizmat që nxisin përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Integriteti fokusohet në respektimin e standardeve etike institucionale, transparencën në lobim, zbatimin e kodeve të etikës dhe masat kundër korrupsionit, duke garantuar një administratë të besueshme dhe të qëndrueshme. Ndërgjegjësimi institucional lidhet me monitorimin dhe vlerësimin e politikave për të siguruar efektivitetin e tyre dhe përshtatshmërinë me parimet e qeverisjes së mirë.

Të dhënat për këtë analizë janë mbledhur përmes shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të publikuara në faqen e internetit të ZKM-së, vlerësimin të kornizës ligjore për transparencën dhe përgjigjeve të ofruara nga institucionet përmes pyetësorëve të strukturuar. Për të garantuar saktësinë e vlerësimin, të dhënat janë verifikuar me një marzh gabimi prej +/- 3%. Procesi i monitorimit është zhvilluar gjatë një periudhe të zgjatur kohore dhe është mbështetur në një qasje të detajuar për të ofruar një pasqyrë të qartë të situatës aktuale.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i kësaj analize është krahasimi i rezultateve të vitit 2023 me ato të viteve paraprake, me qëllim identifikimin e progresit të bërë, sfidave të mbetura dhe fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Ky krahasim ndihmon në vlerësimin e përkushtimit institucional për një qeverisje më të hapur, llogaridhënëse dhe transparente, duke ofruar rekomandime për forcimin e mëtejshëm të këtyre standardeve.

Hapja e Zyrës së Kryeministrit 2022

Gjatë vitit 2022, Zyra e Kryeministrit të Kosovës shënoi një përparim të konsiderueshëm në drejtim të transparencës dhe llogaridhënies, duke arritur një rezultat prej 73% sipas matjeve të indikatorëve të performancës institucionale. Ky rezultat përfaqëson një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitet e kaluara dhe reflekton përpjekjet e ZKM-së për të rritur qasjen e publikut në informacione dhe për të avancuar qeverisjen e hapur.

Gjatë këtij viti, kishte një rritje në publikimin e njoftimeve zyrtare dhe përditësime në rregullimin e përmbajtjes në faqen zyrtare, duke e bërë më të lehtë për qytetarët të kenë qasje në informacione. U përforcua edhe bashkëpunimi ndërinstitucional për ndarjen e të dhënave, gjë që ndihmoi në krijimin e një pasqyre më të qartë për veprimtarinë e qeverisë.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, mbetet ende hapësirë për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në forcimin e mekanizmave të transparencës dhe përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse, si dhe në konsolidimin e kanaleve të rregullta për konsultime publike dhe komunikim efektiv ndërinstitucional.

Zyra e Kryeministrit (ZKM) – Viti 2023

Gjatë vitit 2023, Zyra e Kryeministrit të Kosovës shënoi përmirësim në nivelin e transparencës krahasuar me vitin paraprak. Kjo arritje u realizua falë disa hapave konkretë të ndërmarrë nga ZKM-ja për të forcuar qeverisjen e hapur dhe për të përfshirë më aktivisht qytetarët në proceset vendimmarrëse.

Një nga iniciativat më të rëndësishme ishte lansimi i platformës për konsultime publike konsultimet.rks-gov.net, përmes së cilës qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile kanë mundur të japin komente mbi projektligje dhe dokumente strategjike. Kjo platformë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një qeverisjeje më transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke kontribuar në rritjen e angazhimit qytetar.

Gjatë këtij viti, ZKM gjithashtu filloi të publikojë të gjitha komunikatat zyrtare në të dy gjuhët zyrtare të vendit, shqip dhe serbisht. Kjo masë kishte për qëllim të sigurojë qasje të barabartë në informacion për të gjithë qytetarët, si dhe të minimizojë mundësitë për keqkuptime apo përhapje dezinformatash.

Në përputhje me përpjekjet për më shumë transparencë, ZKM ka garantuar që konkurset për pozita publike të jenë të hapura dhe lehtësisht të qasshme për të gjithë, duke synuar të forcojë drejtësinë dhe integritetin në procesin e përzgjedhjes së zyrtarëve publikë.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ndodhi në korrik 2023, kur ZKM dedikoi një fond të konsiderueshëm për përmirësimin e shërbimeve të komunikimit me publikun. Kjo iniciativë kishte për qëllim të informojë më mirë qytetarët mbi politikën dhe aktivitetet e qeverisë.

Raporti i fundit i Parlamentit Evropian ka vlerësuar progresin e arritur nga ZKM, veçanërisht në përmirësimin e qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, raporti thekson se ka ende hapësirë për përmirësime të mëtejshme, sidomos në forcimin e mëtejshëm të transparencës dhe llogaridhënies.

TRANSPARENCA

Zyra e Kryeministrit ka intensifikuar përpjekjet për transparencë dhe llogaridhënie duke shënuar një rezultat prej 61%. Përmes publikimit të dokumenteve zyrtare, zhvillimit të platformave digjitale dhe forcimit të mekanizmave për konsultime publike, është siguruar një qasje më e lehtë dhe gjithëpërfshirëse në informacionin qeveritar, duke pasur si qëllim një qeverisje më të hapur dhe përfshirje më të madhe qytetare.

Një hap i rëndësishëm drejt transparencës ka qenë publikimi i materialeve zyrtare në uebfaqen e Zyrës së Kryeministrit, përfshirë vendime qeveritare, rregullore, udhëzime administrative dhe dokumente nga mbledhjet e Qeverisë. Ndër dokumentet më të rëndësishme të vitit 2023-2024 është Rregullorja (QRK) Nr. 17/2024, që riorganizon përgjegjësitë e Zyrës së Kryeministrit. Kjo rregullore synon të forcojë qeverisjen e hapur dhe të rrisë transparencën në proceset vendimmarrëse.

Gjithashtu, janë publikuar dokumente strategjike si Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale 2024–2034, Strategjia e Punësimit 2024–2028, dhe Plani i Veprimit për Punësim 2024–2025, duke siguruar që qytetarët të kenë qasje të barabartë në informacion. Përveç këtyre, janë publikuar edhe raporte vjetore të ministrive dhe agjencie qeveritare dhe plane për zbatimin e projekteve.

Në fushën e transparencës financiare dhe prokurimit publik, janë ndërmarrë hapa për të rritur llogaridhënien. Kontratat janë bërë publike në platformën e Komisionit të Prokurimit Publik, dhe është funksionalizuar Moduli për Menaxhimin e Kontratave. Prokurimi elektronik është gjithashtu integruar me sistemin informativ të financave publike, duke e bërë procesin më transparent.

Një hap tjetër është ndërtimi i një baze të dhënash për financimin e organizatave të shoqërisë civile, që ka për qëllim të rrisë transparencën në shpërndarjen e fondeve publike dhe të sigurojë mbështetje të drejtë për sektorin joqeveritar.

Në drejtim të qeverisjes digjitale, janë forcuar platformat për ofrimin e shërbimeve publike, përmes projektit “e-Komuna” dhe digjitalizimit të proceseve gjyqësore, duke e bërë sistemin më efikas dhe të hapur.

Megjithë përparimet, disa sfida mbeten. Raportet financiare, përfshirë ato gjashtëmujore për buxhetin e shtetit, nuk publikohen gjithmonë rregullisht, duke vështirësuar monitorimin nga publiku. Po ashtu, mungesa e një sistemi të integruar për matjen e performancës së institucioneve kufizon analizën objektive të punës së tyre.

Megjithatë, përkushtimi për një qeverisje më të hapur dhe transparente është i qartë. Zyra e Kryeministrit vazhdon të konsolidojë platformat e transparencës dhe të forcojë mekanizmat e llogaridhënies për të siguruar një qeverisje efikase dhe të përgjegjshme.

QASJA

Qasja si parim mat shkallën e përfshirjes së qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe palëve të interesuara në aktivitetet e qeverisë. Në vitin aktual të vlerësimit, Zyra e Kryeministrit (ZKM) ka arritur një rezultat prej 72% në këtë parim, duke reflektuar angazhimin e saj për transparencë dhe pjesëmarrje aktive të publikut.

Një aspekt i rëndësishëm i qasjes është pjesëmarrja e ZKM-së në mediat sociale përmes postimeve të ndryshme ku vëmendja fokusohet në platformat zyrtare të Facebook dhe Twitter. Këto kanale shërbejnë si burime kryesore informacioni për publikun, duke shpërndarë lajme, vendime dhe nisma qeveritare. Përveç kësaj, llogaritë personale të Kryeministrit në Twitter dhe Instagram përditësohen rregullisht rreth informacioneve dhe politikave të aktivitetit të tij. Aktivitetet në këto platforma krijojnë një hapësirë të rëndësishme për komunikim me qytetarët, duke mundësuar ndërveprim të drejtpërdrejtë me publikun dhe palët e interesit. Kjo qasje jo vetëm që përmirëson transparencën, por edhe rrit ndërgjegjësimin dhe angazhimin qytetar.

Për të garantuar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse, ZKM ka ndërmarrë një sërë masash konkrete gjatë vitit 2023-2024. Në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për Konsultime Publike, janë krijuar mekanizma që sigurojnë pjesëmarrjen efektive të qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin vendimmarrës. Agjenda qeveritare është publikuar në uebfaqen zyrtare të ZKM-së, duke garantuar transparencë të plotë mbi planet dhe veprimet e qeverisë. Në të njëjtën kohë, platforma e-qeverisjes eKosova është përdorur për të përmirësuar qasjen e qytetarëve në shërbimet publike dhe për të thjeshtuar procedurat administrative.

Në kuadër të përmirësimit të qasjes në informacion dhe transparencë, janë publikuar kontratat e prokurimit publik dhe procedurat përkatëse në platformat zyrtare të prokurimit, duke forcuar kështu llogaridhënien institucionale. Për më tepër, janë organizuar trajnime për nëpunësit civilë mbi të drejtat për qasje në dokumente publike dhe përdorimin efektiv të mediave sociale për komunikim më të mirë me qytetarët. Për të matur efektivitetin e politikave qeveritare, janë zhvilluar indikatorë të performancës, ndërsa raportet vjetore të punës kanë shërbyer si mjete të rëndësishme për vlerësimin e progresit të institucioneve shtetërore.

NDËRGJEGJËSIMI

Në aspektin e vlerësimit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës sa i përket ndërgjegjësimit, është arritur një rezultat prej 91%, duke reflektuar angazhimin e institucionit në rritjen e transparencës dhe përfshirjes qytetare. Komponenti i ndërgjegjësimit fokusohet në mekanizmat e brendshëm të përdorur për të mbikëqyrur dhe vlerësuar politikat e zbatuara nga Zyra e Kryeministrit.

Sipas Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 mbi punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ekzistojnë mekanizma të qartë për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve strategjike. Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të këtyre politikave, duke përgatitur raporte vjetore mbi progresin e arritur. Gjithashtu, ekziston një strukturë ndërministrORE që siguron mbikëqyrje të rregullt dhe vlerësim të ndikimit të politikave në nivel qendror.

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, Zyra e Kryeministrit ka adoptuar dokumente specifike si Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik dhe Rregullorja mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Këto instrumente rregullojnë procesin e përfshirjes së publikut dhe aktorëve të interesuar në hartimin dhe zbatimin e politikave qeveritare.

Në përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe përmirësuar mekanizmat e mbikëqyrjes, Zyra e Kryeministrit ka marrë pjesë dhe ka organizuar trajnime për nëpunësit civilë mbi qasjen në dokumente publike dhe të dhënat e hapura gjatë viteve 2022-2023. Për më tepër, është funksionalizuar një kanal i drejtpërdrejtë komunikimi për qytetarët për të adresuar shqetësimet dhe ankesat.

Në bazë të këtyre masave, Zyra e Kryeministrit demonstroi përkushtim për një qeverisje të përgjegjshme dhe të hapur, duke siguruar që politikat e saj të mbikëqyren dhe vlerësohen në mënyrë efektive.

INTEGRITETI

Gjatë vitit 2023, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (ZKM) ka ndërmarrë disa masa konkrete për të forcuar integritetin institucional dhe transparencën në administratën publike. Këto përpjekje janë konkretizuar përmes miratimit të rregulloreve të ndryshme që synojnë përmirësimin e strukturës dhe funksionimit të institucioneve shtetërore.

Një nga këto është Rregullorja Nr. 04/2024, e miratuar më 15 shkurt 2024, e cila përcakton organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë. Kjo rregullore synon të sigurojë një funksionim më efikas dhe të rrisë llogaridhënien brenda institutit.

Përveç kësaj, janë miratuar edhe rregullore të tjera që lidhen me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në institucione të ndryshme, si Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe Agjencia për Siguri Kibernetike. Këto rregullore kanë për qëllim të forcojnë strukturën organizative dhe të rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve publike.

Në aspektin e promovimit të integritetit të informacionit, në dhjetor 2024, organizata të shoqërisë civile, media dhe partitë kryesore politike në Kosovë nënshkruan një Kod Sjelljeje për rrjetet sociale dhe mediat online, me mbështetjen e USAID-it. Ky kod synon të krijojë një mjedis të drejtë dhe transparent gjatë fushatave zgjedhore, duke adresuar sfida të tilla si dezinformimi dhe gjuha e urrejtjes.

Të gjitha këto masa reflektojnë qartë përkushtimin e Zyrës së Kryeministrit për ndërtimin e një administrate të qëndrueshme, transparente dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË PUNËN E MASHTI SË NË KOSOVË

ODK, në bashkëpunim me UBO Consulting, ka zhvilluar një anketë për të kuptuar se si qytetarët e perceptojnë dhe përjetojnë punën e Zyrës së Kryeministrit. Në këtë hulumtim janë përfshirë 1310 qytetarë nga të gjitha moshat, gjinitë, etnitë dhe vendbanimet në Kosovë.

Një nga pyetjet kryesore ishte nëse qytetarët besojnë se mund të ndikojnë në punën e Kuvendit. Vetëm 60.3% e të anketuarve u përgjigjën negativisht, duke treguar se shumica e tyre nuk ndihen të fuqizuar për të kontribuar.

Ndërkohë, kur u pyetën sa e ndjekin punën e Zyrës së Kryeministrit, vetëm 5.6% thanë se e përcjellin rregullisht.

Këto rezultate tregojnë se shumë qytetarë ndihen të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse dhe se ka nevojë për më shumë hapësira për pjesëmarrje dhe përfshirje aktive. Sa më shumë të dëgjohen qytetarët, aq më i fuqishëm dhe më demokratik bëhet procesi qeverisës.

REKOMANDIMET

HAPAT E VEPRIMIT

Përkundër përparimeve të dukshme që ZKM ka bërë në drejtim të hapjes dhe qasjes në informacion, ekzistojnë ende disa fusha ku nevojiten përmirësime të mëtejshme për të siguruar një transparencë më të thelluar dhe gjithëpërfshirëse.

Së pari, është e nevojshme të krijohet një sistem i integruar për matjen dhe raportimin e performancës institucionale. Një sistem i tillë do të mundësonte vlerësime më të rregullta dhe më objektive të rezultateve të qeverisë.

Së dyti, publikimi i rregullt dhe në kohë i raporteve financiare përfshirë raportet gjashtëmujore dhe ato vjetore për buxhetin duhet të bëhet një praktikë standarde. Kjo do të ndihmonte në rritjen e llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Gjithashtu, krijohimi i një mekanizmi të thjeshtuar për paraqitjen dhe ndjekjen e kërkesave për qasje në dokumente publike. Një proces më i lehtë dhe më efikas do të siguronte më shumë transparencë dhe do ta bënte këtë të drejtë më të qasshme për të gjithë.

Zyra e Kryeministrit duhet gjithashtu të angazhohet më shumë në promovimin e edukimit qytetar, sidomos sa i përket të drejtës për informim dhe përdorimit të platformave digjitale. Kjo do t'i fuqizonte qytetarët për të marrë pjesë më aktivisht në procesin e politikëbërjes.

Së fundi, për të siguruar që politikat publike të reflektojnë nevojat e qytetarëve, është e domosdoshme që konsultimet publike të zhvillohen me transparencë të plotë duke përfshirë agjenda të qarta, raportim të rezultateve dhe pjesëmarrje sa më të gjerë të shoqërisë civile, veçanërisht në fazat e hershme të hartimit të politikave.

RAPORTE TË TJERA TË NGJASHME

RAPORTE TË TJERA

Eksploroni raporte dhe dokumente shitesë të ngjashme me këtë raport të disponueshme në faqen e publikimeve të Open Data Kosovo.

WWW.OPENDATAKOSOVO.ORG/PUBLICATIONS

Nëse keni pyetje shitesë, mos ngurroni të kontaktoni:

info@opendatakosovo.org